

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Delta Cooperation And Investment “ SHPK

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia

Neni 1: Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot më datë 15.05.2020, në mbështetje të legjislacionit shqiptar respektivisht Ligjet Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Ligjet Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, une Ortaku i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **“Delta Cooperation And Investment”** Shpk, formuloj Statutin e saj, si me poshë vijon,

Ortakët e shoqërisë janë:

1. **LUAN MUÇA**, e datëlindjes 05.08.1971, lindur ne Elbasan, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi H10805062A

Neni 2: Objekti

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si vijon:

- Investitor ne fushen e ndertimit te objekteve te ndryshme civile dhe industriale, private dhe shteterore, social kulturore. Ndertimi, rikonstruksioni dhe mirembajtja e tyre e punimeve germimi ne toke, ndertime civile dhe industriale, rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasada, etj. Punime per prishjen e ndertimeve, impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri dhe mirembajtja e tyre. Punime rifiniture te muratureve dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese. Ndertime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri. Punime strukturore speciale, shtresa dhe mbistruktura speciale, punime mbi shina dhe

- traversa, impjante teknologjik, termike dhe te kondicionimit, impjante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni, impjante te brendshme, elektrike, telefon, radiotelefoni TV etj. Restaurime te ndertesave civile dhe industriale, restaurimi ne monumentet e arkitektures, restaurimi i monumenteve te trashegimise kulturore, zbatim ne restaurimin e Qendrave Historike e Kulturore,etj. Ndertime me karakter social kulturor dhe te kulteve te ndryshme fetare.
- Import - eksport, tregtim me shumice e pakice te materialeve te ndërtimit si pllaka, kollë, stuko, fino, bojak, bojra sintetike e natyrale me bazë pigmentesh hekuri dhc atyre organike, materiale hidrosanitare, artikuj mobilimi shtëpie, parkete druri, laminate etj.
 - Transport kombetar dhe nderkombetar mallrash brenda dhe jashte vendit.
 - Shoqeria sipas nevojave te aktivitetit ka te drejten e ushtrimit te çdo aktiviteti te ligjshem, te lejucshem per formen e shoqerise, c cila nuk ndalohet me ligj(sipas nenit 7 te Ligjit nr.9901,dt.14.04-08).

Neni 3: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 4: Selia

Selia e shoqërisë do të jetë:

Kashar, Mezes, Autostrada Tr-Dr, Km 5, Godina DELTA SHA, Tirane.

Shoqeria mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjensi në të gjithë territorin e Shqiperise si dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjet e vendeve ku ato hapen.

Kreu II

Kapitali i regjistruar

Neni 5: Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar

Kapitali i shoqërisë është **100.000 (njëqindmije) EURO**, i ndarë në 1 kuote.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

Luan MUÇA, është zotëruar i 1 kuote, me 100% pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë me vleren 100.000 Euro

Neni 6: Pagesa e kuotave

Administratorët mund t'i kërkojnë ortakëve pagimin e kontributeve në para të pashlyera në lidhje me kuotat e tyre.

Në rast të mos shlyerjes së kontributeve, sipas përcaktimit të administratorit, personi përgjegjës do të paguajë një kamatë vonesë mbi shumën e papaguar me interes prej 4% në vit.

Neni 7: Kalimi i kuotave

Kalimi i kuotave dhe i të drejtave që rrjedhin prej tyre, mund të bëhet me:

- kontratë shitblerje,
- dhurim
- trashëgimi
- me çdo mënyrë tjeter të parashikuar me ligj.

Neni 8: Zmadhimi e zvogëlimi i kapitalit themeltar

Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke irritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.

Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë të kualifikuar të votave.

Kreu III

Asambleja e përgjithshme

Neni 9: Të drejtat dhe detyrimet

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë,
- b) ndryshimet e statutit,
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve,
- d) emërimin dhe shkarkimin e likujdatorëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar,
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhc të raporteve të ecurisë së veprimtarisë,
- f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit,
- g) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre,
- h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve,
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë,
- j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë,
- k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 10: Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- a) Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori të paktën 2 herë në vit, për të miratuar përkatesisht bilancin vjetor të mbyllur dhe bilancin vjetor parashikues.
- b) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një shkrese dërguar çdo ortaku me postë të zakonshme ose mesazh elektronik. Njoftimi duhet të kryhet të paktën 7 ditë përpala datës së caktuar për mbledhjen.
- c) Ortakët, që zotërojnë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar kanë të drejtë të thërrasin mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet administratorit ose edhe pa ndërmjetësimin e tij.

Neni 11: Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

- a) Mbledhja e Asamblesë është e vlefshme nëse në të marrin pjesë ortakë që zotërojnë më shumë se 30% të aksioneve, për të vendosur për çështje të

zakonshme. Në këtë rast vendimi i Asamblesë është i vlefshëm nëse është votuar nga shumica e votave të ortakëve pjesmarrës.

- b) Mbledhja e Asamblesë, për të vendosur për çështje të veçanta si: ndryshimi i statutit, zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, është e vlefshme nëse në të marrin pjesë ortakë që zotërojnë më shumë se 50% të kuotave. Në këtë rast vendimi i Asamblesë është i vlefshëm nëse është votuar nga jo më pak se tre të katërtat e votave të ortakëve pjesmarrës, (c cilësuar në këtë statut si "shumicë e kualifikuar").
- c) Mbledhja e Asamblesë drejtohet nga administratori nëse është e thirrur prej tij. Nëse Asambleja e Përgjithshme është thirrur nga pakica, atëherë ajo kryesohet nga njëri nga ortakët e zgjedhur nga pjesëmarrësit në atë mbledhje.
- d) Administratori pavarësisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marri fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 12: Votat e Pjesëmarrësve

- a) Çdo ortak ka te drejta vote ne perpjasetim me vleren nominale te kuotes se tij.
- b) Asnjë ortak nuk voton në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet, që kanë të bëjnë me kuotat, që ai disponon.

Neni 13: Emërimi i Administratorit

- a) Administrimi si dhe perfaqesimi I shoqerise I besohen nje ose me shume Administratoreve qe mund edhe te mos jene ortake.
- b) Administratori emerohet per 5- vjet nga regjistrimi I shoqerise prane QKR-se, me te drejte riperteritje, me perjashtim doreheqje apo shkarkimi nga ana Asamblese.
- c) Detyra e Administratorit te vetem i ngarkohet Z. Luan MUÇA, te cilit i jetet e drejta e firmes dhe e perfaqesimit e shoqerise.
- d) Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë në çdo kohë Administratorin nga detyra, me shumicë të zakonshme votash, me kusht që në mbledhje të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave

Neni 14: Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet:

- a. të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme,
- b. të përfaqësojë shoqërinë,
- c. të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë,
- d. të bëjë të mundur përgatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe të nënshkruajë bilancin vjetor parashikues për vitin e ardhshëm, për tu miratuar nga Asamblea e Përgjithshme, brenda dates 20 tetor të vitit paraardhës.
- e. të bëjë të mundur përgatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe të nënshkruajë bilancin vjetor të mbyllur, për tu miratuar nga Asamblea e Përgjithshme, brenda dates 20 mars të vitit të ardhshëm dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim,
- f. të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë,
- g. të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë,
- h. të raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare,
- i. të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe statut.

Neni 15: Mbledhjet e Administratorit

Administratori kujdeset që në libra të posaçëm të mbajë proces verbalet e të gjitha takimeve të kryera nga ai, si dhe të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.

Shpërndarja e fitimit vjetor të shoqërisë

Neni 16: Shpërndarja e fitimit vjetor

- a) Pjesa e fitimit që i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë, vendoset të shpërndahet nga asambleja e përgjithshme.
- b) Asambleja e Përgjithshme ka kompetencë t'u shpërndajë ortakëve pjesën e fitimit në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.
- c) Po ashtu, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që një pjesë e fitimit vjetor të mos u shpërndahet ortakëve, por këto shuma të përdoren për zmadhimin e kapitalit filletar apo për qëllime të tjera, të cilat ajo i konsideron të dobishme për shoqerinë.

Kreu VII

Prishja dhe njoftimet

Neni 17: Prishja dhe likuidimi

- a) Në rast të likuidimit të shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme emëron një likuidator, i cili administron shoqerinë deri në mbylljen e proçesit të likuidimit.
- b) Me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë të kualifikuar, pasi janë shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve të shoqërisë, likuidatori shpérndan pjesën e mbetur të pasurisë së shoqërisë ndërmjet ortakëve. Kjo shpërndarje e fundit bëhet në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

Neni 18: Ftesa për kreditorët

Likuiduesit duhet të stojnë kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj të internetit, si dhe në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitoohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.

Neni 19: Përfundimi i likuidimit

- a) Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetur, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë

- b) Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.


Neni 20: Dispozitat e fundit

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e këtij statuti.

Për çdo gjë tjeter, që nuk është shkruar shprehimi i statutit, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKB-në si dhe çdo ligj tjeter mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Ortaku i Shoqerise

Luan MUÇA



The image shows a handwritten signature in black ink. Above the signature, the name "Luan Muça" is written in a cursive font. Below the name is a stylized, swirling signature consisting of several loops and curves.